

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**VEGA ENERGY**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "VEGA ENERGY" Sh.p.k, e përbërë nga:

1. **BRUNO PAPAJ**, person fizik, shtetas Shqiptar i lindur më datë 09.10.1993, në Fier, Shqipëri dhe banues në Tiranë identifikohet nëpërmjet pasaportës me nr. BJ9879290, me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **PHILIPP KORONOWSKI**, person fizik, shtetas Gjerman, i lindur më datë 04.04.1996, Wuppertal, Gjermani dhe banues në Aachen, Gjermani identifikohet nëpërmjet pasaportës me nr.C6ZZ3ZYFF me zotësi të plotë për të vepruar.

Në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjisacionit Shqiptar, vendosen të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë "VEGA ENERGY" Sh.p.k. mbi bazën e këtyre principeve:

**NENI 1**  
**FORMA DHE EMRI**

**1.1** Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributeve të ortakëve në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë "VEGA ENERGY" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**BAZA LIGJORE**

**2.1** Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9901. datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përputhje me legjisacionin Shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3**  
**SELIA**

**3.1** Selia e shoqërisë është në adresën Rruga "Ndre Mjeda", kompleksi rezidencial Magnet, në pasurinë nr 3/491+10-N2, vol 59 fq 37, në ZK: 8220, Tiranë.

Në adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

**NENI 4**  
**KOHËZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË**

**4.1** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likujdimi me vendim të Asamblesë së Ortakeve, sipas rasteve të parashikuara në ligj.

## **NENI 5** **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**5.1** Shoqëria "VEGA ENERGY" Sh.p.k është e organizuar në formën e një shoqërie, e cila ka si objektiv ndërtimin e centraleve Fotovoltaikë (Diellore), të cilat bëjnë të mundur prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinasueshme Fotovoltaikë. Shitja e energjisë elektrike klienteve dhe blerja e energjisë elektrike nga operatorë të ndryshëm privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit. Transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjekcionin ndërkontinentar. Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjeve transformuese për transmetimin e energjisë elektrike. Shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori final. Kryen shërbime konsulencë dhe ndërmjetësimi për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta, këtu përfshihet marketingu dhe prodhimi i sistemeve elektronike (Software), komponentët e sistemeve periferike për burimet e rinasueshme. Tregtim dhe mirëmbajtje e makinerive të teknologjisë së lartë, elektrike dhe pajisjeve elektronike. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/panelevë fotovoltaikë, elektroshtepiakë, elektronike, sistemeve/impianteve termike, të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme per mire menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, te telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme te destuguara per objekte civile dhe industriale, per sektore të ndryshme. Shitja me shumice dhe pakice brenda dhe jashtë vendit te materialeve të ndryshme elektrike dhe pajisjeve të tyre te gjitha llojeve te materialeve të tjera industriale, si impiante ndriçimi, impiante të energjisë alternative, impiante të mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrierash dhe kontrollit të dedikuar, impiante kundra grabitjes, zjarrit, permbytjeve dhe gazrave, impiante videovezhgimi CCTV dhe speciale, impiante per transmetim te dhenash dhe telekomunikacioni etj. Tregtim i energjisë nga burime te rinasueshme. Konsulencë dhe cdo aktivitet që lidhet me fushen e energjisë. Tregtim te artikujve te ndryshem industrial dhe ofrimi i shërbimeve me keto artikuj. Shërbim konsulencë në fushën juridike, financiare, inxhinierike dhe të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri në bazë të legjislacionit Shqiptar dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet në mënyrë direkte dhe indirekte dhe që i shërben përmbytjeve së aktiviteteve si më lart.


## **NENI 6** **KAPITALI THEMELTAR**

**6.1** Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 2 pjesë. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

<b>1. BRUNO PAPAJ</b>	<b>50,00%</b>	<b>50.000,00 LEKË</b>
<b>2. PHILIPP KORONOWSKI</b>	<b>50,00%</b>	<b>50.000,00 LEKË</b>

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe është depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

## **NENI 7** **AKTET E SHOQERISE**



2



7.1 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 8**  
**ORGANET DREJTUESE**

- 14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori.
- 14.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar Administratorët e shoqërisë "VEGA ENERGY" Sh.p.k, ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.
- 14.3 Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohet kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.
- 14.4 Administratori i shoqërisë **Zj. Suela Ereqi** është emëruar për një periudhe 5 (pesë) vjeçare. Në rast se në vijim do të emërohen administratorë të tjera ata mund t'i ushtronin kompetencat e tyre bashkarisht ose veç e veç.


**NENI 15**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

- 15.1 Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet, kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.
- 15.2 Ky Akt-themelimi është hartuar me 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën Shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njejtë ligjore.

Tiranë, 03/10/2022

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**  
**VEGA ENERGY SH.P.K**

BRUNO PAPAJ



PHILIPP KORONOWSKI



SUELA EREQI

